



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 82 paragrafët 2 dhe 3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, në pajtim me Rregulloren (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) 06/2021, nenit 53 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative nr.05/L-031, neneve 14, 15 paragrafi 2.4, dhe nenin 90 paragrafët 2 dhe 3 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, sipas Shkresës së Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural nr.1255/6 të datës 23.03.2022, për vlerësimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Podujevës, Kuvendi i Komunës së Podujevës, pas rishqyrtimit të aktit, në mbledhjen e mbajtur më 29 prill 2022, mori këtë,

V E N D I M

Neni 1

Me këtë Vendim, anulohet vendimi i Kuvendit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-550/01-0014605/22 për shpërndarjen e druve të zjarrit për familjet me gjendje të rëndë ekonomike, i miratuar nga Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2022.

Neni 2

Anulimi sipas nenit 1, bëhet për shkak se Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në procedurën e vlerësimit të ligjshmërisë, përmes Shkresës nr.1255/6 datë 23.03.2022, ka vlerësuar se akti në fjalë është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë nuk mund të prodhojë efekte juridike, konkretisht me nenin 12 paragrafi 29.12 të Ligjit nr.03/L-153 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/3 për pyjet e Kosovës, duke theksuar se mbrojtja e pyjeve është kompetencë e deleguar në Komuna, konfiskimi i masës drusore nga shërbimi i mbrojtjes së pyjeve është e hyrë e Komunës dhe procedohet në pajtim me dispozitat e Ligjit të prokurimit publik të Kosovës.

Neni 3

Vendimi hynë në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqe zyrtare të Komunës së Podujevës.

Nr.prot. 01-016/01-0050738/22
Podujevë, datë, 29 prill 2022



Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha